

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-24-0889****Në ankesën e****Paditësi****O H R-** Prishtinë, i përfaqësuar nga avokat M B dhe R F.**Kundër****E Paditura/ankuesja****Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani si Gjyqtar Kryesues, Asllan Krasniqi dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-23-0267 të datës 13 nëntor 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III -23-0267 të datës 13 nëntor 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me datë 23 dhjetor 2010, paditësi e dorëzoi një padi pronësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në bazë të kontratës

së shitblerjes. Në padi ka pohuar se mes paditësit dhe të paditurës është lidhur, dhe është vërtetuar në tërësi kontrata me shkrim nr.ODY./2006 dt., mbi shitblerjen e patundshmërisë – hapësirës afariste në rr. “.” nr, Qendra Tregtare (QT), Prishtinë, me sipërfaqe prej 108 m², përdhese si dhe podrumi në sipërfaqe prej 142m², me çmim prej 95.000.€ i cili çmim është paguar në tërësi. Paditësi ka pohuar se i është drejtuar Drejtorisë për Kadastër Prishtinë për regjistrim të pronës, mirëpo ka marr përgjigje se nuk mund të bëhet regjistrimi pasi që nuk kanë shënime për këtë pronë dhe se regjistrimi do të mund të bëhet vetëm mbi bazën e aktgjyqimit të formës së prerë, andaj edhe i është drejtuar gjykatës me padi si dhe me propozim për caktimin e Masës së Sigurisë. Me padi paditësi ka bashkangjitur këto prova: Kopja e kontratës për shitblerjen e pronës së paluajtshme e lidhur në Shkup dt., Kopja e aktvendimit të Drejtoratit për Financa dhe Pronë KK Prishtinë nr.010-413/1956-19945 dt.09.08.2010, Kopja e taksës për regjistrimin e patundshmërisë nr.012202dt.09.08.2010, Kopja e procesit për pranim të instalimit elektrik dt.19.10.2010, Kopja e faturës në KEK sh.a në emër të paditësit dt.19.12.2010, Kopja e faturës në KEK sh.a në emër të paditësit dt.01.10.2010, Kopja e faturës në KEK sh.a në emër të paditësit dt.01.12.2010, Kopja e skicës së lokaleve, Kopja e konfirmimit dt.05.09.2006, Kopja e njoftimit të KK Prishtinë dt.20.08.2010, Kopje e autorizimit në gjuhën serbe, Shkresë, Kopja e kontratës së shitjes nr. dt., Shkresë në gjuhën serbe – e pa lexueshme, Kopje e aktvendimit.

I autorizuari i paditësit me datë 03.08.2017, përmes parashtresës e ka njoftuar gjykatën se pala e paditur nuk ekziston – është shuar, e që për këtë rrethanë vërtetohet nga regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë dhe Regjistri i personave juridik nr..dt.. Si provë i ka bashkangjitur Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

Me datë 3 tetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Prishtinës, përmes të cilës ka kërkuar informacione për të dhënat për pronarin e objektit lëndor, të konstatohet se e ka pasur ndërrime të regjistrimeve të pronarëve, si dhe si janë bërë azhurimet.

Komuna e Prishtinës i është përgjigjur gjykatës me datë 11 tetor 2017, duke e njoftuar gjykatën se nuk mund të dërgon të dhënat e kërkuara për arsye se sistemi kadastral nuk gjeneron të dhënat pa e pasur numrin identifikues të njësisë banesore.

Me datë 29 nëntor 2017, autorizuari i paditësit i është drejtuar gjykatës me parashtresën, duke e njoftuar se heq dorë nga podrumi në sipërfaqe prej 142 m², pasi që kjo është shënuar gabimisht në kontratën e shitblerjes. E ka bashkangjitur Faturën e tatimit në pronë të datë 24.12.2013 në emër të paditësit.

I njëjti i është drejtuar gjykatës edhe me parashtresën e datë 22 dhjetor 2017, ku ka pohuar se Fabrika e Këpucëve Kona Sport "Komuna" Prizren, lokalin që është objekt i kësaj padie ia ka shitur në vitin 1981 ndërmarrjes "Gazellës" nga Shkupi. Me këtë partashtresë paditësi ka bashkangjitur kopjen e kontratës datë 23 korrik 1981. Ai pohon se si pronar i këtij lokali para se blente O R i ishte ".a" nga Shkupi. Bashkë me këtë parashtresë ka bashkangjitur Kontratën e shitëblerjes, vendimin e Këshillit të punëtorëve datë 17 prill 1981, si dhe Aktvendimin e Sekretariatit për Ekonomi të Komunës së Prishtinës të datë 5 shtator 1981.

Me datë 13 korrik 2018, paditësi ka paraqitur një parashtresë për precizim të objektit të padisë, përmes të cilës ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit O R nga fshati G e E komuna e Lipjanit dhe të Vërtetohet se paditësi O R i është pronar në bazë të kontratës së shitblerjes ODY..datë .maj .. e lidhur në mes të tij dhe ". – Shkup për pronën e patundshme – lokalin afaristë i cili gjendet në rr. ". nr., Qendra Tregtare II, nën Hotel Grand, Prishtinë në sipërfaqe prej 108 m², kati përdhes që identifikohet në katastrin me numër .., lokali nr.. I ka bashkangjitur skicat e lokalit.

Me datë 24 prill 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin C.nr.2853 është shpallur in kompetente lëndore në këtë çështje, dhe lëndën me të gjitha shkresat ia ka dërguar DHPGJS-së. Kjo lëndë paqstaj regjistrohet me numrin C-III-23-0267.

Me datë 23 tetor 2024, i autorizuari i paditësit ka paraqitur kërkesë për caktim të masës së sigurisë, ku ka pohuar se paditësi është pronar i lokalit afaristë i cili është objekt i këtij contest,i dhe se e drejta subjektive në këtë rast është e padiskutueshme dhe se e paditura përmes shpalljes së shitjes së këtij lokali e ka krijuar një situatë urgjente duke e rrezikuar shkaktimin e dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm. Pa u lëshuar në çështjen meritore, e paditura nuk ka pas të drejtë që ta administroj dhe ta vendos në shitjen lokalin që është objekt i këtij kontesti me dt.30.10.2024, kur dihet se “.” është shuar dhe sot evidentohet si shoqëri aksionare (jo aktive). E njëjta është transformuar në shoqëri aksionare para vitit 1989.Ka shtuar se paditësi ngarkohet me pagesat e tatimit në pronë, shërbimet e energjisë elektrike, shërbimet e ujësjellësit në emër të lokalit afaristë – objekt i këtij kontesti. Tutje është e padiskutueshme se është plotësuar kushti ligjor i të drejtës subjektive, dhe se ekziston rreziku i dëmit të menjëhershëm dhe të riparueshëm. Ky objekt i kontestit i përket një ndërmarrje e cila asnjëherë nuk ka qenë e regjistruar në Kosovë, e që është jashtë juridiksionit ligjor të AKP-së. Që nga viti 1989 e deri në vitin 2023, ky aset nuk është administruar asnjëherë nga AKP apo paraardhësi i saj juridik AKM, për arsye se ky nuk ka qenë një subjekt juridik i regjistruar në Kosovë. Ka kërkuar që të aprovohet kërkesa për Caktimin e masës së sigurimit si e bazuar, dhe të ndalohet të paditurës – kundërshtares së sigurimit që të ndërmarr çfarëdo lloj veprimi në drejtim të shitje, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit-administrimit me paluajtshmërinë objekt i këtij procesi, deri në zgjidhjen meritore të kësaj çështje. Me këtë parashtresë paditësi ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e kontratës së shitblerjes së paluajtshme datën 10.05.2006 në gjuhën shqipe dhe serbe, Kopjen e një kontratë në gjuhën serbe, Shkresë në gjuhën serbe, Kopje e vërtetimit dt.01.12.2017, Kopja e të dhënave për asetin – shitja e aseteve përmes likuidimit numër 69 njësia e vendosur në tender numër 43 - Gazela Lokali në Prishtinë, Kopja e Rregullat e përgjithshme të tenderit – 2023, Kopje të faturave të tatimit në pronë, Kopje të fletë deponimeve, Kopje e procesit për pranimit të instalimit elektrik dt.19.10.2010 si dhe kopje të faturave të energjisë elektrike, Kopje të faturave të ujësjellësit, Kopje e regjistrimit qendror të Republikës së Maqedonisë - Regjistri Tregtar dhe Regjistri i Personave Juridik të tjerë dt.11.01.2017, Kopja e

përmbledhjes të të dhënave të regjistruara në regjistrin e regjistrave – në gjuhën serbe.

Me datë 31 nëntor 2024, e paditura ka paraqitur përgjigjen e saj, duke i kundërshtuar pretendimet e palës paditëse të paraqitura në kërkesën për masën e sigurisë duke i konsideruara te pa bazuara në ligje. Me teje e paditura në përgjigje shton se aset për të cilin pretendon pala paditëse, janë aset shoqërore dhe ato bien nënë juridiksionin dhe administrimin e AKP-së. AKP konsideron se në këtë rast të gjithë operatorët e ndryshëm, si ata fizik dhe juridik që shfrytëzojnë apo gjinden në shfrytëzim të këtyre aseteve pa lejen dhe pa autorizimin e AKM-së tani AKP-së, e kanë statusin e shfrytëzuesit arbitrar dhe të kundërligjshëm, duke përfshirë edhe palët që e shfrytëzojnë e nëse nuk dëshmojnë bazën juridike të shfrytëzimit, si kontratën për shfrytëzim, shtojnë në përgjigje se argumentimin ligjor bazohet në një punë të pavlefshme juridike dhe se puna juridike e paditësit ka qenë në kundërshtim me ligjin në fuqi Ligjin për Qarkullimin e pasurive të paluajtshëm i vitit 1981 me ndryshime dhe plotësime 29/86 dhe 28/88(neni 9) në rastin kur është lidhur kontrata. AKP –ja konsideron se paditësi me provat e paraqitura në mbështetje për caktimin e masës së sigurisë nuk paraqesin argumente ligjore të arsyeshme për lëshuarjen e Masës së sigurisë, dhe mbi këtë si palë e paditur kërkojmë refuzimin e propozimit të paditësit të kërkuar për lëshuarjen e Masës së Sigurisë si të pa bazuar.

Me datë 13 nëntor 2024, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me Aktvendimin C-III-23-0267 kërkesën e paditësit për caktimin e Masës së Sigurisë e aprovon si të bazuar. Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS ka arsyetuar se në këtë rast janë përmbushur kriteret e nenit 61 të Ligjit të Dhomës së Posaçme të lëndës për caktimin e masës së sigurisë për lokalitetin afarist me numër njësisë kadasrale 0-..., me sipërfaqe prej 113 m² ish aset i shoqërisë aksionare “”, i cili ndodhet në Rr..p.n, ish qendra tregtare nën Grand Hotel përball pallatit të rinisë (brenda monumentit “Heroinat”) në qendër të Prishtinës.

Kolegji vlerëson se paditësit Osman Ramadani nga pretendimet e pohuara në padi dhe në kërkesën për masë të sigurisë si dhe me provat e dorëzuar në gjykatë: Kopjen e kontratës për shitblerjen e pronës së paluajtshme e lidhur në Shkup, Kopja e

aktvendimit të Drejtoratit për Financa dhe Pronë KK Prishtinë nr.. datë . gusht ., Kopja e taksës për regjistrimin e patundshmërisë nr.012202 datë 9 gusht 2010, Kopja e proces për pranim të instalimit elektrik datë 19 tetor 2010, Kopja e faturës në KEK-ut sh.a në emër të paditësit datë 19 dhjetor 2010, Kopja e faturës në KEK-ut sh.a në emër të paditësit datë 1 tetor 2010, Kopja e faturës në KEK-ut sh.a në emër të paditësit datë 1 dhjetor 2010, Kopja e skicës së lokaleve, Kopja e konfirmimit datë 5 shtator 2006, Kopja e njoftimit të KK Prishtinë datë 20 gusht 2010, Kopje e autorizimit në gjuhën serbe, Shkresë, Kopja e kontratës së shitjes nr.. datë . korrik ., Shkresë në gjuhën serbe – e pa lexueshme, Kopje e aktvendimit. E te cilat prova për Kolegjin konsiderohen te mjaftueshme për te preventtuar-ndaluar shitblerjen-tjetërsimin ne personat e trete pa periodikuar-paragjykuar zgjedhjen përfundimtare të lendes ne mënyrë meritore me padi. Po ashtu gjykata vlerëson se demi mund te jete i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm ne saje te përshkrimeve paditore dhe provave aktuale ne shkresat e lendes ashtu qe me qellim qe te përvetohet ne mos shtijën e lokalit në fjalë-tjetërsimin e të njëjtit për personat e tretë pa u sqaruar vlersushmëria e padisë përmes mbajtjes dhe komunikimeve shkresore gjykata vlerëson se mbizotëron arsyeja që masa e sigurisë me provat aktuale qe gjenden ne shkresat e lendes te lëshohet për derisa të mos vërtetohet e kundërta siç pretendon e paditura AKP-ja. Gjykata po ashtu ka vlerësuar dhe përgjigjen e te paditurës e cila kundërshtuar pretendimet e paditësit duke theksuar se e kundërshtojnë ne tërsi me pretekstin se asetit ne fjalë është ne juridiksionin e tyre, me pas duke theksuar se kane autoritetin mbi asetin ne fjale duke u thirrur se janë ne shfrytëzim arbitrar me vet faktin se nuk kanë leje nga ana e tyre, duke shtuar se asetit shfrytëzohet nga personat e tretëm pa bazë ligjore. Gjykata i vlerësoj këto pretendime mirëpo si te tilla ne këtë faze, nuk paraqiten dëshmi nuk u mbështeten me kundër argumente përveç deklarimit te tyre se kane juridiksion për çka gjykata në këtë faze i konsideroj vetëm si deklarime pa mbështetje për vendosjen ne te kundërtën, ngase fare nuk kishin përgjigje ne lidhje me provat e dorëzuara ne gjykate nga paditësi. Nga ajo qe u tha me lartë kolegji konsideron se kushtet e nenit 61 mbi DHPGJS-në janë plotësuar vetëm sa i parkete për caktimin e masës se sigurisë sipas propozimit te paditësit O R i nga Lipjani, dhe e cila masë e sigurisë e aprovuar nga kolegjit i DHPGJS-se dhe do te mbetet ne fuqi deri ne gjykimin përfundimtar të padisë.

Me datë 27 nëntor 2024, AKP-ja përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-III-23-0267 të datës 13 nëntor 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe të refuzohet kërkesa e paditësit për caktimin e Masës së Sigurisë si e pa bazuar. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se me Aktvendimin e ankimuar është shkelur neni 182.2(nënpika n) të LPK-së pasi që ky Aktvendim është kontradiktor me vetveten, me arsyetimin e dhënë, me provat e administruara si dhe nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se gjendja faktike në këtë rast është vërtetuar gabimisht, pasi që Aktvendimi i DHPGJS është bazuar në një kontratë të shitblerjes që nuk është në përputhje me ligjin dhe me kompetencat përkatëse të AKP-së. Pavarësisht se kontrata është lidhur në një shtet tjetër, DHPGJS-së i është paraqitur një dokument që është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë për të vërtetuar një marrëdhënie ligjore të ligjshme për caktimin e Masës së Sigurisë. Tutje AKP-ja pohon se nuk është marrë parasysh fakti se vetëm ajo në bazë të ligjit ka kompetencën për privatizimin e aseteve të NSH-së si dhe faktin se kjo kontratë nuk mund të ketë efekte ligjore në territorin Kosovës. AKP-ja pohon se për të njëjtin kontest gjyqësor është edhe një lëndë tjetër në pritje me numër C-III-24-0089 lidhur me pretendimet tjera ndaj pronës lëndore, dhe ky fakt nuk është marrë parasysh. Tutje AKP-ja konsideron se për shkak të zbatimit të gabuar të gjendjes faktike gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale dhe konsideron që nuk ka pasur kushte ligjore të caktohet Masa e Sigurisë.

Me datë 9 dhjetor 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjen në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi ka kundërshtuar të gjitha pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështesin Aktvendimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në këtë parashtresë paditësi ndër të tjera kanë pohuar se Aktvendimi i ankimuar nuk përmbajnë asnjë të metë ligjore ndërsa pretendimet ankimore janë vetëm përshkrime si të tilla nuk qëndrojnë dhe nuk duhet të merren për bazë. Tutje paditësi pohon se aktvendimi nuk është i përfshirë me shkelje procedurale apo zbatim të

gabuar të së drejtës materiale siç pretendon paditësja pasi që janë shqyrtuar të gjitha faktet vendimtare. Tutje paditësi pohon se Aktvendimi i ankimuar nuk ka shkelje procedurale siç pohon AKP-ja andaj pretendimet e tilla janë të pa bazuara. Gjykata ka shqyrtuar t[gjitha faktet dhe provat të cilat palët kanë propozuar dhe të cilat gjenden në shkresa të lëndës, andaj pretendimet se nuk janë shqyrtuar faktet vendimtare janë të pa bazuara dhe ato pretendime nuk qëndrojnë. Paditësi nga arsyet e cekura ka kërkuar nga Kolegji i Apelit të refuzohet ankesa e AKP-së, dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kriteret se kur duhet të lëshohet Masa e Sigurisë përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: fumus boni iuris (probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe periculum in mora (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-

së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: Padiësi/Ankuesi i cili kërkon Masë të Sigurisë duhet të dëshmoj probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkon, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet Masa e Sigurisë e cila kërkohet.

Në këtë lëndë, Kolegji i Apelit vëren se padiësi me padinë e tij të dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 23 dhjetor 2010, ai ka kërkuar të vërtetohet e drejta e tij e pronësisë për pronën e paluajtshme – hapësirën afariste e cila gjendet në rrugën " . ", nr ., Qendra Tregtare II, në Prishtinë në sipërfaqe prej 108 m2 përdhesë, dhe 142 m2 podrum.

Kolegji i Apelit vëren se padiësi me parashtrësën e tij të datës 29 nëntor 2017, ka hequr dorë nga kërkesa për vërtetim të drejtës së pronësisë lidhur me podrumin në sipërfaqe prej 142 m2, pasi siç pohon kjo është shënuar gabimisht në kontratën e shitblerjes.

Kolegji i Apelit vëren se padiësi padinë e tij pronësore e mbështetë në kontratën e shitblerjes të lidhur mes ndërmarrjes ". " në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe padiësit O R nga Prishtina.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Fabrika e Këpucëve " Komuna " në Prizren me kontratën e shitblerjes të dates . korrik ., paluajtshmerinë lëndore të padisë ia ka shitur, ndermarrjes "Gazela" në Shkup. Bazuar në këtë fakt vërehet se shitësi i paluajtshmerisë lëndore të padisë, ndermarrja "Gazela" kishte një kontratë të shitblerjes që deri para se të filloj kjo procedure, nuk është kontestuar nga askush, në bazë të cilës Kontratë kjo ndermarrje pronën lëndore të padisë, ia ka shitur padiësit.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja ka pretendime se këto kontrata nuk mund të prodhojnë efekte ligjore në teritorin e Kosovës, duke pretenduar se më herët nuk ka

pasur proces ligjor të privatizimit, dhe se vetëm AKP-ja mbanë përgjegjësi ligjore të privatizimit të aseteve të NSh-së.

Këto pretendime i ka pasur parasysh Kolegji i Apeli,t por megjithëatë janë pretendime që nderlidhen me meritat e padisë, e të cilat sigurisht do të shqyrtohem gjatë procedurës në vazhdim nga Klegji i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

Siç ka konstatuar saktë Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, paditësi ka sjellë prova në mbështetje të padisë dhe kërkesës për caktimin e masës së sigurisë, që në këtë faze të procedurës nuk mund të injorohen lehtë, janë prova të mjaftueshme vper këtë faze të procedurës që të caktohet Masa e Sigurisë.

Kjo prone është tenderuar nga AKP-ja në shitjen për mes likuidimit nr. 69, dhe kjo prone në tender është vendosur në numrin rendor 43. Hapja e ofertatave ishte caktuar me datë 30 tetor 2024.

Andaj tjetërsimi eventual i kësaj prone përmes procesit të privatizimit nga ana e AKP-së, tek personat e tretë, kjo gjë do të pamundësonte kthimin e kësaj prone tek paditësi, andaj në këtë fazë të procedurës ka nevojë që kjo pronë të mbrohet me Masë të Sigurisë.

Prandaj nga arsyet e cekura, Kolegji i Apelit e mbështetë konstatimin e Kolegjit të shkallës së I-rë se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 61.1 i LDHP-së që të caktohet masa e sigurisë, dhe të mbrohet kjo pronë nga shitja deri sa të vendoset në merita të padisë.

Prandaj nga këtë arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ky Aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejudikon zgjidhjen e meritave të padisë.

Nga sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumën prej 100 euro, me datë 06 dhjetor 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit të DHPGJS, me 26 dhjetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
